



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 19.05.2022, me fillim në ora 10:00. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Defrim Kafexhiu**.

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni të ju përshëndes të gjithëve, nënkryetarin **Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorë të drejtorive, përfaqësuesit e OSBE-së, mediave dhe të gjithë ju të pranishëm. Faleminderit shumë për pjesëmarrjen, e hapim mbledhjen e 4-të të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Të nderuar anëtare të KPF-së për këtë mbledhje propozoj këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i propozim - vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave Komunale për biznese;
3. Shqyrtimi i propozim - vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik parcelën P-71513005-02756-0 në Zonën Kadastrale Krushë e Madhe;
4. Shqyrtimi i vendimit për bartjen e mjeteve rezervë në investime kapitale;
5. Shqyrtimi i propozim - vendimit për themelimin e komiteteve për Arsim dhe Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale;
6. Shqyrtimi i vendimit për përbërjen dhe organizimin e Komitetit për Arsim;
7. Shqyrtimi i vendimit për përbërjen dhe organizimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale;
8. Shqyrtimi i Draft - Rregullores për dhënien e titujve të nderit, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Rahovecit;
9. Shqyrtimi i vendimit për aprovimin e listës së anëtarëve të zgjedhur të Këshillit të Fshatit Hoçë e Madhe;
10. Raporti vjetor i Punës së Komitetit të Auditimit për vitin 2021;
11. Raporti i Auditorit të Brendshëm për periudhën e vitit 2021;
12. Të ndryshme

Kryesuesi – Përshëndetje për të gjithë, të nderuar anëtarë të komitetit për politikë dhe financa, i nderuar nënkryetar, të nderuar drejtorë të drejtorive. Po fillojmë kështu mbledhjen e 4-të të KPF-së, për këtë mbledhje kemi përgatitur gjithsej 12 pika të rendit të ditës...

Para se të kalojmë te miratimi i rendit të ditës, a kemi ndonjë propozim shtesë ose propozim për largimin e ndonjë pikë?

Bejtullah Deliu – Përhëndetje i nderuar kryesues, zv.kryetar, drejtorë të drejtorive, kolegë të nderuar. Me disa kërkesa nga qytetarët e Krushës së Madhe dhe asamblistit tonë që ka qenë i zëshëm rreth kësaj pike, pikën nr.3 konkretisht që është tani, kërkesë parësore ka qenë diskutimi me qytetarë por nuk po e shoh ka ndodhur një gjë e tillë, prandaj propozoj që të hiqet nga rendi i ditës. Faleminderit.

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkryetar, kolegë drejtorë, të nderuar anëtar të KPF-së. Në lidhje me propozimin e shefit të grupit parlamentar të PDK-së për tërheqjen e këtyre pikave që kanë të bëjnë me Krushën e Madhe, një parcelë ta shpallim me interes të përgjithshëm dhe dy të tjera për caktim të lokacionit për hapësirë për biznese. Ne si drejtori kemi përgatitur historiatin e këtyre parcelave, i kemi bashkangjitur vendimet e kuvendit të komunës prej pasluftës për këto zona, gjithashtu edhe vendimi i kuvendit para luftës që është vendosur në mbrojtje Kanioni i Drinit të bardhë. Ky kuvend para luftës në vitin 2004-2006 ka vendosë që njëra prej këtyre parcelave t'i jepet në shfrytëzim bizneseve, deri në momentin që këto kompetenca i ka marrë ministria e mjedisit. I njëjti kuvend para 15 viteve e më shumë ka vendosë që këtu të shesin zhavorr. Një shqetësim e kam unë, nëse ne pranojmë të diskutojmë me uzurpatorë do të hapim terrene të panjohura në Xërxe. Në qershor kemi në plan si kuvend të caktojmë hapësira për biznes në Xërxe dhe dihet që 20 vite si në Krushe në Xërxe deri në Mrasor, këta që i kanë pas në shfrytëzim këto prona padrejtësisht, nuk tërhiqen lehtë. Nëse ju vendosni t'i tërhiqni këto pika nga rendi i ditës, krijohet një precedent që të bisedojmë me njerëz që i kanë shfrytëzuar pronat padrejtësisht 20 vite (pastrimi te stacioni i autobusëve), kjo i bie që ju po vendosni standard, që ne mos të vendosim para se të flasim me uzurpatorë.

Sipas gjeodezisë këto prona janë të pastërta, këto parcela nuk u janë marr askujt, nuk ka konteste gjyqësore. Me gjithë drejtorinë do të shkoj në Krushë dhe do të bisedoj me ta, t'iu them atyre që e gjitha që dëshirojmë të bëjmë është se këtë hapësirë me hektarë do ta shndërojmë në hapësirë për biznese, ku të gjithë kanë të drejtë aplikimi e jo veç një person.

Po kërkonin që ne ta heqim prej rendit të ditës këtë pikë, e në anë tjetër uzurpatori të vazhdoj shfrytëzimin. E unë po kërkoj prej grupeve parlamentare t'i shtyjmë përpara këto pika, sepse bizneset çdo ditë vijnë te ne dhe kërkojnë hapësirë, duhet t'i kalojmë pikat bashkërisht dhe t'iu ndajmë hapësirat në mënyrë të drejtë.

Bejtullah Deliu – Faleminderit kryesues, i nderuar drejtor një përmirësim, më herët the “para lufte” e më pastaj “2004-2006”. Nuk e di sa isha i qartë drejtor, unë nuk jam i atij mendimi që ju të bisedoni me uzurpatorë, ashtu siç i quani ju, por është kërkesë eksplicite e anëtarit tonë të kuvendit që të diskutoni me qytetarë me ftesë zyrtare, përveç asaj nëse ju mendoni që ka uzurpatorë, ju i posedoni disa ligje këtu, duhet të bëni hapa tutje, ne nuk mund t'iu rregullojmë mangësitë që ju i keni bërë. Edhe një herë po e përsërisë; me qytetarë nga Krusha e Madhe të mbahet një takim dhe të njoftohen për rrjedhojat e më tutjeshme, ndoshta ata nuk janë pro që krejt kjo parcelë të kaloj për biznese, kanë dëshirë që një pjesë t'i takojë bujqësisë dhe gjërave tjera. Nuk kisha preferuar që ju të mendoni që ne po i përkrahim uzurpatorët, fjala uzurpatorë vërtetohet me ligj, nëse ende nuk e keni vërtetuar atëherë nuk ka uzurpatorë. Nëse mbani takimin dhe i bindni qytetarët që është në të mirën e komunitetit, unë jam gjithmonë pro. Faleminderit.

Besmire Bytyqi – Faleminderit shumë i nderuar kryesues, nënkryetar, drejtorë, kolegë këshilltarë. Drejtori Afrim në fjalën e tij tha që do të shkojmë të vizitojmë bizneset, qytetarët si dhe do të mbajmë një takim me ta. Unë e mbështesë propozimin e drejtorit Afrim, meqë kemi edhe pak më shume se 10 ditë deri te mbledhja e kuvendit, konsideroj që mund të mbahet një takim me qytetarët e Krushës së Madhe lidhur me parcelën në fjalë dhe pajtohem me drejtorin që nuk duhet lejuar uzurpatorët të vazhdojnë uzurpimin. Prej vitit 2004 meqë është ky problem, konsideroj që prej këtij viti shumë qeverisje, drejtorë, inspektorë janë ndërruar, nuk ka qenë vetëm Aleanca. Faleminderit.

Bejtullah Deliu – Faleminderit kryesues, mos të kapemi për pika e presje, momentalisht e keni mandatin e tretë, ndoshta keni mundur të ndërmerri ndonjë gjë në këtë aspekt, sepse kjo ide nuk lindi tani kur po flasim, janë vite të tëra. Së paku shterni mundësitë ligjore dhe morale me qytetarët, nuk jam kundër asaj që po kërkohet, por së paku sa ma afër qytetarëve me takime. Faleminderit.

Fatmir Iska – Faleminderit i nderuar kryesues, anëtarë të KPF-së, drejtorë dhe të gjithë të pranishëm.

Doja të ndërlihem me Bejtullahun më herët, që sa i përket uzurpatorëve është çështje ligjore dhe i trajton ligji. Diskutimet me qytetarë do të bëhen për një investim i cili do të ndodh për zhvillimin e ekonomisë në komunën tonë. Ato janë prona komunale dhe një është e ujërave nëse nuk jam gabim, kryesisht janë prona shtetërore. Eksploatuesit e zhavorrit që unë tash po i quaj uzurpatorë, sepse ligji i trajton ashtu, duke e shfrytëzuar pronën pa asnjë dokument me pretendime qysh para formimit të kadastrës (1953). E përmendi drejtori pastrimin e "1 majit" te stacioni i autobusëve, ka pas shumë pretendent me shantazhe, kërcënime duke thënë që është pronë e tyre.

Gjykata me vendim të formës së prerë kur posedon një vendim që kjo pronë i takon personit të caktuar, atëherë jemi në rregull. Ne do të shkojmë për diskutim me qytetarë rreth një investimi për shpalljen e një zonë me interes të veçantë për zhvillimin e bizneseve, kjo është ideja e komunës dhe është nën diskrecionin e secilit anëtarë të kuvendit të votoj pro ose kundër. Kërkesa jonë është që këto pika të kalojnë edhe në KPF edhe në kuvend, nëse vazhdojmë me mospajtime të tilla atëherë kjo "status-quo" e uzurpatorëve do të vazhdojë. Faleminderit.

Burim Krasniqi – Faleminderit kryesues, nënkryetar, kabinet qeveritarë, anëtarë të KPF-së.

I dëgjova me vëmendje Bejtullahun, ekzekutivin dhe nënkryetarin, është fakt që në seancën e fundit kur i kemi larguar prej rendit të ditës këto dy pika për Krushën e Madhe, kryetari është zotuar që do ta mbajë një takim me qytetarët e Krushës, nëse nuk është e vërtetë i kthehemi procesverbalit kur të vjen në seancë edhe e shikojmë. Takimi nuk ka ndodh, së paku nuk kemi informacion dhe nuk e besoj që është joligjor bashkëbisedimi me banorët atje. E përgëzoj komunën për veprimin që ka marrë te parcela (ish-1 maji) dhe i ftoj t'i largoj të gjithë uzurpatorët nëpër prona publike në komunën e Rahovecit. E kam edhe një kërkesë tjetër, raporti i auditorit (pika 11) është qesharake. Raporti i auditorit është me një faqe e gjysmë, konsideroj që është ofendim total për KPF-në dhe asamblenë. Kërkoj që raporti vjetor i punës i auditimit të shtyhet për seancën e radhës, poashtu rekomandoj që pika e 11 rendit të ditës të shtyhet për seancën tjetër.

Fatmir Iska – Ne kemi qenë në një takim me krushianë, kemi diskutuar dëgjimin publik për buxhet, por është ngritur si qështje edhe ky problem për parcela, kryesisht prej atyre që kanë pretendime aty duke thënë; Ka qenë e babagjyshit tim, nuk guxon askush të ma merr pronën etj...

Kështu që ju lus, ta përkrahim këtë pikë të rendit të ditës për Krushë të Madhe, të shkon në kuvend diskutimet vazhdojnë në kuvend edhe pse nuk d.m.th që kjo të kaloj aty patjetër, varet prej kuvendarëve. Edhe nëse votohet kundër, mbas një muaji përsëri mund ta bëjmë gati për rend dite, me një diskutim paraprak me juve dhe të ecim tutje.

Burim Krasniqi – Nuk është e hijshme që një parcelë me interes të përgjithshëm, të mos kaloj në assemble, duhet ta bëjmë situatën që kur ta kemi këtu, kjo pikë të kaloj. Ne mund të kemi për çështje politike mospajtime tjera, por për pronë publike si asamblistë nuk guxojmë të kemi sepse është interes i përbashkët, sot ballafaqohet Smajl Latifi, nesër Bejtullahu etj.. nuk ka të bëjë kjo me individ, por me komunën dhe interesin e përgjithshëm. Në këtë kuptim le ti shterim mundësitë që kur të vije në assemble vetëm mundemi ta klasifikojmë ne shfrytëzim për biznese, apo vetëm interes të përgjithshëm dhe automatikisht duhet ta ketë pëlqimin e të gjithë asamblistëve.

Fatmir Iska – Ne vetëm hipotetikisht mund të kemi pretendime të palëve (para 70 viteve ose para formimit të kadastrës) kjo është pronë publike, drejtori e përmendi që nuk ka asgjë në gjykatë lidhur me këto prona, me kënd të diskutojmë në këtë rast dhe çka?...

Besë Bytyqi – I dëgjova me shumë vëmendje parafolësit, konsideroj që drejtori Afrim, bashkë me kryetarin dhe nënkryetarin duhet ta bëjnë një takim me banorët e Krushës dhe me pretendentët për atë zonë, gjithashtu edhe ne të jemi prezent aty. Këtë pikë duhet ta votojmë që të shkoj në kuvend dhe të mbahet takimi, të diskutojmë bashkë jo vetëm në kuvend por edhe jashtë tij. Mos t'i shtyjme pikat për shumë muaj radhazi sepse nuk konsideroj që dikush ka benefit për këtë gjë, përveç personave që kanë interes direkt. Faleminderit.

Afrim Oruqi – Kryetari është njëri prej kryetarëve të rrallë që nuk heziton të ketë takime edhe pse nënkryetari tha që më shumë se një orë e gjysmë kanë pas bisedë. Para kuvendit do ti takojmë përsëri.

Ju ftoj njerëzisht, juridikisht mos t'i shtyjme këto pika se iu japim oksigjen këtyre uzurpatorëve, ti dërgojmë në kuvend këto, e ne të hanën ose të martën do të takohemi me qytetar të krushës dhe pretendent të pronave, e ju në kuvend vendosni për uzurpim ose për shfrytëzim për biznese. Mos i përkrasni njerëzit që kanë uzurpuar, ju kërkojmë sinjerisht që propozimi le të kalon për kuvend.

Bejtullah Deliu – I nderuar drejtor, është mirë që këtë term ta largojmë prej fjalorit, por mirë e ka Burimi kur thotë se nëse janë uzurpatorë, shumë më herët është dashur të reagojmë. Kur kemi interes të përgjithshëm këtu asnjëherë nuk është ndal diçka. Kur nuk keni pas të drejtë, jemi munduar për përmirësime, kemi kërkuar prej seancës së kaluar një takim me qytetarë të Krushës, tash po del që një bashkëbisedim ka ndodh që paraprakisht nuk na keni njoftuar. Mendoj që kjo pikë nuk duhet të vije fare në seancë, të shkojmë bashkërisht të bisedojmë me banorë dhe me ata njerëz që janë duke operuar aty që unë nuk mund t'i them uzurpatorë pa marr një verdikt të tillë, nëse vërtetohet prapë është mangësi e juaja që nuk keni bërë asgjë kundër tyre, kemi mundësi ligjore, jemi shtet.

Fatmir Iska – Kryesuesi e vendos tash në votim, a hiqet apo nuk hiqet pika është prapë çështje e juaja. Ta zëmë takohemi me qytetarë atje, para mbajtjes së seancës dhe takimi nuk merr asnjë epilog! Çka tutje? Kemi pas “dëgjim publik për buxhet” d.m.th natyra e takimit ka qenë tjetër gjë, për atë arsye nuk ju kemi lajmëruar paraprakisht. Nëse jeni dakord para seancës do ta caktojmë një takim me kryetarin e fshatit, aty mund të merr pjesë secili qytetarë dhe shkojmë për veprime tutje.

Kryesuesi – Faleminderit nënkryetar, atëherë po e vendosim në votim propozimin e Bejtullah Deliut për largimin e pikës 2 dhe 3 për një periudhë tjetër kohore ose për seancën e radhës! Kush është PËR largimin e këtyre dy pikave? KUNDËR ? ABSTENIM nuk ka. Me 4 vota për dhe 3 kundër kalon propozimi i Bejtullah Deliut për largimin e këtyre dy pikave të rendit të ditës nga kjo mbledhje.

Propozimi tjetër është i Burim Krasniqit për largimin e pikës së 11 të rendit të ditës “Raporti i auditorit të brendshëm për periudhën e vitit 2021. Meqenëse këtu e kemi zyrtarin e auditimit, nëse ka ndonjë pyetje ose ndonjë kërkesë? Faleminderit, kush është PËR? KUNDËR? ABSTENIM? Pra, pika e 11 e rendit të ditës shtyhet për në seancën tjetër. Vazhdojmë me propozimin tjetër, ky është i imi si anëtar i KPF-së. E kemi një kërkesë nga një grup i taksistëve në komunën e Rahovecit që kanë bërë një kërkesë për plotësim-ndryshimin e rregullores nr.01811 e miratuar me 31 gusht 2015 për ushtrimin e veprimtarisë së transportit-taksitë për udhëtarë. Kërkesa e tyre është që neni 1 i rregullores të ndryshohet ku thotë; Ushtrimi i veprimtarisë të transportit (taksi), për moslejimin e ushtrimit të veprimtarisë pas moshës së pensionimit (65 vjeçare), në këtë rast kjo rregullore po iu bënë problem grupit më të madh të taksistëve. Po e vendosim në votim këtë propozim! Kërkesa është pranuar në zyrën time dhe si kryesues e paraqes para KPF-së, në diskutim edhe me nënkryetarin.

Besë Bytyqi – Faleminderit, nuk kemi material për këtë kërkesë, duhet të jemi në dijeni çka të votojmë e çka jo, ju ftoj të na bëni nga një kopje, pas leximit dhe konsultimit nëse e shohim të arsyeshme e votojmë ose jo.

Kryesuesi – Faleminderit Besë, po vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës pa propozim, po e bëjë tërheqjen e propozimit duke e lenë për mbledhjen tjetër të KPF-së, vijmë me kopje dhe iu dërgoj edhe më herët. Atëherë kush është për miratimin e rendit të ditës me gjithsej 9 pika? Atëherë me shumicë votash miratohet rendi i ditës. Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës “Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar” ndonjë diskutim rreth procesverbalit?

Burim Krasniqi – Një gabim teknik në faqen 4, pika 4 Raporti vjetor i punës së komitetit të auditimit, te kryesuesi, ku thuhet; e qesim në votim propozimin e Burim Krasniqit për largimin e pikës 4 të rendit të ditës me 2 vota për, 2 abstenim, 1 kundër- kalon, kalkulimi i votave nuk është në rregull, shikojeni mirë punën e votimit këtu se diçka nuk është në rregull.

Kryesuesi – Faleminderit Burim, procesmbajtësi është në një udhëtim zyrtar jashtë vendit, besoj që ky lëshim do të përmirësohet... Po e vendosim në votim pikën e parë të rendit të ditës, kush është PËR? Me shumicë votash aprovohet pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë te pika e dytë që është;

“Shqyrtimi i vendimit për bartjen e mjeteve rezervë në investime kapitale”, e ftoj drejtorin e financave z. Afrim Limani për prezantimin e kësaj pike.

Afrim Limani – Përsëritje për të gjithë, çka janë rezervat? Pjesa e mjeteve financiare apo investimeve kapitale të cilat janë të nënshtruara në udhëzimin administrativ 04-2019 udhëzim ky që përcakton qartë definimin e projekteve kapitale. Zbatimi i këtij udhëzimi ka filluar nga viti 2021 d.m.th është hera e dytë që lista e projekteve kapitale i nënshtrohet këtij udhëzimi, kështu që për fat të keq komuna jonë i ka 10 projekte me vlerë 690.000eu të kalojnë në rezerva. Në raport i keni të gjitha projektet në kuadër të drejtorisë së shërbimeve publike, në bujqësi, planifikim urban dhe mjedis si dhe në shëndetësi dhe mirëqenie sociale, nëse ka nevojë edhe projektet i lexoj para juve. Në bazë të analizave të bëra, ideja dhe qëllimi ynë është që këto mjete rezervë prapë të orientohen në të njëjtat projekte përafërsisht në mënyrë analoge, sepse kemi kontrata të lidhura gjithashtu edhe obligime financiare në kuadër të këtyre projekteve që kanë kaluar në rezerva. Pas konsultimeve që i kam bërë me departamentin e buxhetit të ministrisë së financave, ne propozojmë bartjen në po të njëjtat projekte në të cilat kemi obligime financiare dhe kontrata në vazhdim. Po e lë hapësirën për pyetje të ndryshme!

Burim Krasniqi – Faleminderit për shpjegimin drejtor, te propozim-vendimi dhe te shkresa informuese për bartjen e mjeteve mungon një arsyeshmëri e shkruar, pse ka ndodh kjo gjë? Baza ligjore pse po ndodh ky kthim në rezervë? Sepse shqetësimi im është nëse këto mjete janë kthyer për nga keq kualifikimi, mund ta bëjmë një tjetër keq kualifikim me emër ndryshe, duhet ta kemi në shpjegim të formës narrative për këtë gjë. Faleminderit shumë

Afrim Limani – Unë thash që iu kemi nënshtruar udhëzimit administrativ 04-2019, për seancën e mbledhjes së rregullt unë mundemi me ju dorëzuar këtë udhëzim në formë të kopjes fizike ose në email, përpos që jam bazuar në ligj, kam bërë edhe konsultime me departamentin e buxhetit dhe ju garantoj që këto nuk kanë me u rikthyer asnjëherë, sepse janë të definuara qartë.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, ndonjë diskutim tjetër? Atëherë po e vendosim këtë pikë në votim, kush është PËR?... Me shumicë votash aprovet pika e 4 e rendit të ditës shqyrtimi i vendimit për bartjen e mjeteve rezervë në investime kapitale. Jemi te pika e 5-të e rendit të ditës

Shqyrtimi i propozim - vendimit për themelimin e komiteteve për Arsim dhe Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, sipas propozimeve që i kemi pas në mbledhjet e kaluara të KPF-së, si dhe pas votimit me shumicë votash për iniciimin e procedurave për themelimin e këtyre dy komiteteve, këtu e kemi vendimin, të dy komitetet përbehen nga 5 anëtarë, për formën dhe numrin e anëtarëve i kemi dy pika tjera, kështu që pikën e 3-të e rendit të ditës po e vendosim në votim; kush është PËR? Me shumicë votash aprovet pika e 5-të e rendit të ditës, kalojmë te pika e 6-të e rendit të ditës **Shqyrtimi i vendimit për përbërjen dhe organizimin e Komitetit për Arsim**, mënyrën e organizimit të këtij komiteti e ka bërë zyra ligjore, unë po e vendosi në votim me një propozim tjetër; sipas udhëzimit administrativ 05-2020 neni 14 pika 2 thotë; shumica e anëtarëve të komiteteve tjera përbehen nga anëtarët e kuvendit si dhe duhet të reflektojnë përbërjen e kuvendit të komunës, meqenëse është kështu, brenda asamblesë komunale kemi 4 grupe të asamblistëve, propozoj që këtij vendimi t'ia bashkëngjisim propozimin që 4 grupet e asamblistëve ta kenë nga një përfaqësues në këtë komision dhe anëtar i pestë i komisionit të përbëhet nga një ekspert i jashtëm. Atëherë po e vendosim në votim në këtë formë! Kush është PËR?... Atëherë me shumicë votash aprovet vendimi për përbërjen dhe organizimin e komitetit për arsim. Po vazhdojmë te pika e 5-të e rendit të ditës që është; **Shqyrtimi i vendimit për përbërjen dhe organizimin e komitetit për shëndetësi dhe përkujdesje sociale**, po e vendosim në votim në të njëjtën formë, kush është PËR?... Me shumicë votash aprovet edhe pika e 5-të e rendit të ditës. Kalojmë kështu te pika e 6-të e rendit të ditës; **Shqyrtimi i draft rregullores për dhënien e titujve të nderit-dekoratave dhe çmimeve nga komuna e Rahovecit**.

Afrim Dina – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkryetar, drejtorë, anëtar të KPF-së. Para jush kemi draft rregulloren për hartimin e dhënies së titujve-dekoratave-çmimeve të komunës së Rahovecit. Rreth draft rregullores janë kryer të gjitha obligimet ligjore, me datën 03.02.2022 kryetari ka formuar grupin

punues për hartimin e kësaj rregulloreje, që deri më tani komuna jonë nuk e ka pasur. Kemi organizuar edhe takimin publik me qytetarë rreth kësaj teme i cili është mbajtur me datën 12.04 në sallën e kuvendit, në konsultim publik rregullorja ka dal me datë 28.03, ka përfunduar me pjesën ligjore me 28.04. Komentet që kemi pasur nga qytetarët janë të implementuara në rregullore. Kjo rregullore përbëhet nga; dekorata - qytetar nderi, dekorata nderi i komunës, dekorata “Ukshin Hoti”, dekoratë për humanizëm “Dr. Ali Sokoli”, medalja e lirisë, medalja sportisti i vitit, çmimi letrar “Sylejlam Krasniqi”, çmimi lexuesi i vitit, mirënjohjet dhe falënderimet, gjithashtu këtu janë të parapara edhe dekoratat postmortem. Të nderuar anëtarë të KPF-së, para vete e keni materialin se si duket, dekorata “Ukshin Hoti” vlen të përmendet që në mbledhjen e kaluar është kaluar çmimi, i cili do të jepet një here në vit pikërisht në ditëlindjen e tij me 17 qershor. Ju ftoj për aprovim pas shqyrtimit.

Rumir Zhuniqi – Faleminderit drejtor Afrim Dina, përshëndetje kryesues, nënkryetar, drejtorë, kolegë asamblistë. E përgëzoj drejtorin për këtë prezantim, kisha propozuar me këtë rast të shtohet edhe një çmim, bujku i vitit ose fermeri i vitit, meqë jemi komunë bujqësore. Nëse jeni të pajtimit e propozoj.

Afrim Dina – Faleminderit i nderuar Rumir, propozim jashtëzakonisht me vend. Duhet ta gjejmë një emër të përbashkët ku mund të përfshihet të gjithë në një (vreshtarët, perimtarët, blegtorët etj...)

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, atëherë nëse nuk ka ndonjë diskutim për këtë temë, po e vendosim në votim; kush është PËR?... Me shumicë votash aprovohet pika e 6-të e rendit të ditës. Vazhdojmë të pika e 7-të; **Shqyrtimi i vendimit për aprovimin e listës së anëtarëve të zgjedhur të Këshillit të Fshatit Hoçë e Madhe**; Atëherë këtu e kemi raportin për vendimin që kemi marrë në kuvendin komunal më 30 mars 2022 për formimin e komisionit, komisioni takimin e parë e ka mbajtur më 13 maj 2022 kanë qenë 12 kandidatë (7 të komunitetit Serb, 5 Shqiptarë) komunitetet tjera nuk i janë përgjigjur ftesës. Komisioni ka vendosë që në kuvend t'i ketë 7 emra, kryetar i komisionit është zgjedhur Lirigzon Kastrati i cili sot nuk është i pranishëm për raportim sa i përket takimit të parë.

Në këtë rast, kërkoj që takimi i parë i komisionit të anulohet, sepse është pozicion i palakmueshëm për kuvendin komunal nëse i delegohet përgjegjësia për përzgjedhjen e anëtarëve të këtij këshilli. Komisioni duhet të vijë me një pako të kandidatëve, të bëjë përzgjedhjen, jo vetëm selektimin. Nëse e kam mbështetjen nga ju që komisioni ta mbajë edhe një takim dhe në seancën e rregullt të kuvendit ta kenë raportin dhe pakon me 4 kandidatë dhe t'i votojmë njëkohësisht të gjithë.

Besë Bytyqi – Është hera e parë që dëgjojë diçka të tillë. Kryesues, si po mendoni ju që ata të vijnë këtu me 4 emra dhe ne t'i votojmë duke mos e ditur se kush janë ata, ku është esenca e votës time e të kolegëve këtu? Nuk shkon kjo votë në pako, kjo është votë individuale z. Kryesues, ky është propozim absurd dhe konsideroj të vazhdojmë në të njëjtën mënyrë se si ka ardhur në KPF.

Kryesuesi – Nuk e kam dokumentin për moment këtu Besë, por është shumë e logjikshme, i njëjti kuvend komunal që i ka dhënë kompetencat komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve. Sipas udhëzimit administrativ është një nen i cili thotë; komisioni ad hoc e bën zgjedhjen e kandidatëve.

E marrë si ofendim këtë, për arsye se në praktikat e kaluara kuvendi ka vendosë për të njëjtin këshill të fshatit, komisioni i atëhershëm në kuvend ka ardhë me 4 emra në pako. Nuk po flasë për “hava” sepse i kam lexuar dhe shqyrtuar procesverbalet e më hershme për formimin e këshillit të fshatit Hoçë e Madhe, kështu që nuk d.m.th që nëse vjen pakojë duhet patjetër ta votojmë, pa keqkuptime sepse as në praktikat e mëhershme nuk i kemi pas 7 emra për këshill të fshatit në seancën e rregullt të kuvendit komunal, unë si kryesues e kam për detyrë mbrojtjen e interesave të asamblesë komunale, për këtë arsye komisioni duhet ta kryej punën siç parashihet në udhëzim administrativ që thotë; komisioni e bënë zgjedhjen, jo selektimin. Faleminderit

Rumir Zhuniqi – Faleminderit kryesues, në këtë rast kisha kërkuar shpjegim nga zyra ligjore, praktikat e mëhershme here ju konvenojnë, here jo. Thjeshtë duhet të bazohemi në ligj me një sqarim nga zyra ligjore. E përgëzoj komisionin sepse e ka kryer punën duke e bërë raportin. Faleminderit.

Besë Bytyqi – E meritoj vëmendjen e kryesuesit, në mandatin e kaluar nuk ka ardhur si pako dhe nuk e kemi votuar si pako, e mbajë në mend 100% detajisht kënd e kam votuar dhe kush nuk ka kaluar. Kështu që nuk mundet me ardhë si pako e ne t'i votojmë 4 persona të zgjedhur nga komisioni, unë dëshiroj t'a shoh biografinë e kandidatëve.

Kryesuesi – Besë, nuk po them unë që komisioni kur bën përzgjedhjen ata kalojnë në kuvend. Kuvendi është ai që vendosë, vijnë 4 kandidatë sepse komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve e ka këtë punë, sipas jush 12 kandidatë t'i kemi në kuvend, nuk e shoh të arsyeshme. Kuvendi delegon komisionin për përzgjedhjen e anëtarëve, nëse kuvendi nuk vendosë që ata 4 kandidatë të përzgjidhen, atëherë e ftojmë komisionin për 4 kandidatë tjerë. Përshëndesim edhe kryetarin e komunës z. Smajl Latifin, i urojmë mirëseardhje në KPF.

Kryetari – Faleminderit kryesues, anëtarë të KPF-së, drejtorë të drejtorive. Në qoftëse anëtarët e KPF-së kanë marr mundit të ndërhyjnë në punë të komisionit, i cili është kryesisht i hutuar nga opozita, atëherë këto veprime janë kontradiktore dhe votim kontradiktore. Komisioni duhet të bëjë punën e tij, kur të vije raporti i punës së komisionit në kuvend atëherë vlerësohet, diskutohet, votohet ose jo. Komisioni ka metodologjinë e vet të punës, mandatin e ka prej kuvendit të komunës, ky komision përbehet me anëtarë që më shumë i takojnë opozitës. Do të ishte mirë që komisioni t'i bie 3 emra apo sa duhet, por ne nuk mund t'ia caktojmë detyrat komisionit në KPF përmes një votimi formal. Është mirë të ketë ndërgjegje çdo kush, se nuk ka ndodhur asnjëherë në këtë kuvend të ndërhyjmë me këtë ashpërsi dhe kaq drejtpërdrejt në komision. Duhet t'ia lëmë punën organeve të cilat i kemi krijuar në këtë kuvend dhe në fund diskutohet në kuvend pastaj votohen emrat të cilët e meritojnë mandatin. Ju lus të gjithëve që mos votoni diçka para kohe, sepse komisioni e bënë punën e tij që ne ia kemi besuar, më pas vjen në seancë para juve për diskutim dhe vlerësim të punës dhe votohet përmes kuvendit. Kjo tentative ose propozim i kryesuesit nuk prodhon asgjë, se komisioni përsëri ka të drejtë dhe thotë jemi të votuar prej kuvendit dhe vij në kuvend jo me 4 kandidatë, por me 7 në kuvend e diskutojmë pse 7 kandidatë. Nuk është mirë që ne t'i tregojmë komisionit përmes KPF-së se çka duhet të bëjnë, ne kuvend i tregojmë secili nga ne. KPF nuk është mekanizëm që dikton punën e një organi të themeluar në kuvend. Kuvendi vendosë për punën e komisionit, për dobitë, të mirat, defektet që ka mundur t'i ketë në punën e vet, kjo është praktika parlamentare, ligjore.

Bejtullah Deliu – Përshëndetje kryesues, kryetar mirëserdhe dhe faleminderit për angazhim. Unë paraprakisht mund të pajtohem me kryesuesin rreth propozimit, por jo në këtë formë. Argumentimi i kryetarit ishte real, sepse nëse ne e kemi zgjedhur një komision atëherë duhet të jetë profesional. Gabim trashanik është që komisioni sot nuk është këtu, ose kryetari i komisionit të na tregoj punën dhe mendoj që në seancë do të kemi më shumë punë me ata, ndoshta në seancë ta ndryshojmë formatin ose ta kthejmë pas, mirëpo tash për tash nuk kemi alibi për diçka që kemi votuar ta ç 'votojmë. Faleminderit.

Kryesuesi – Faleminderit Bejtullah, pajtohem edhe me kryetarin pjesërisht, duhet ta gjej një formë për ti bërë thirrje komisionit të mbajnë edhe një takim. Ndoshta tentimi im për vendosje në votim, nuk ishte forma e duhur, por e bëjë një thirrje që komisioni në seancë të rregullt të kuvendit të vijnë me një propozim të 4 anëtarëve, jo të 7.

Kryetari – Komisionit gjithmonë mundemi me i bë thirrje, ideja është që në qoftëse komisioni vlerëson situatën dhe thotë që ende ka punë, ata e dinë vet, e kanë pavarësinë duke u bazuar në mandatin që iu ka dhënë kuvendi, me këtë logjikë po flasë se nuk ka nevojë për votim.

Kryesuesi – Në rregull është, pajtohem plotësisht, po e terheki edhe propozimin.

Fatmir Iska – Faleminderit kryesues, komisioni ka bërë përzgjedhjen e anëtarëve, të cilët kanë aplikuar në bazë të përvojës që kanë...Në këtë komision i kemi 3 anëtarë të pakicës dhe 2 anëtarë të kuvendit, njëri prej tyre shefi i grupit të VV-së Leonard Morina, tjetri asamblisti Lirigzon Kastrati. Në momentin e përzgjedhjes të anëtarëve për këshill të fshatit, këta është dashur të jenë në dijeni sepse janë anëtarë të kuvendit. Tjetra, udhëzimi administrativ nuk i precizon saktë, çka nëse unë, kryetari i komunës dhe Bejtullahi e kemi të njëjtin fakultet dhe përvojën e punës njëjtë? Cilin ta përkrahim? Për këtë arsye detyra e komisionit është përzgjedhja e aplikantëve mbi bazën e udhëzimit administrativ, kuvendi është ai që i miraton.

Bejtullah Deliu – Nënkryetar, elaborimi ishte në vijë, unë nuk po them që 7 anëtarë janë shumë, po kanë mundur të jenë edhe 20 të kualifikuar me kritere të plotësuar. Unë anëtarët i shoh njerëz që gabojnë, mund të ketë gabime. Ndoshta mungesa e tyre këtu në KPF është e arsyeshme, por mendoj që para seancës duhet të elaborojmë për secilin kandidatë, ta dimë kënd e votojmë, e çka votojmë. Ndoshta është mire që brenda kësaj pike të jetë një tjetër shtesë, që në kuvend komisioni të na tregoj kualifikimin e secilit kandidatë në bazë të kërkesave që kanë qenë. Faleminderit

Fatmir Iska – mendoj që kjo pikë e rendit të ditës duhet të kalohet në kuvend dhe të vazhdohet diskutimi atje. Kryesuesi i komisionit raporton punën e vet, unë asnjëherë nuk kam pas ndonjë kritik ndaj komisionit sepse vet e ka bërë përzgjedhjen dhe nuk është detyra ime ta kritikoj. Po ju them që prej të gjithë këtyre aplikantëve, asnjë nuk është në radhët e AAK-së, jemi të hapur të shprehim përkrahje të cilido që e vlerësojmë.

Kryesuesi – Faleminderit Bejtullah dhe nënkryetar, atëherë po e vendosim në votim pikën e 7 të rendit të ditës, kush është PËR? ...me shumicë votash aprovohet pika e 7 e rendit të ditës. Vazhdojmë te pika e 8-të; **Raporti vjetor i Punës së komitetit të auditimit për vitin 2021**, e ftoj anëtarin e komitetit të auditimit z. Sead Boshnjakun për prezantim të raportit.

Sead Boshnjaku – Përshëndetje për të gjithë, unë jam anëtar i komitetit të auditimit të brendshëm, në mungesë të kryesuesit Sead Rama, sot po e zëvendësoj. Raporti vjetor i komitetit të auditimit të brendshëm, për periudhën raportuese komiteti i auditimit ka shqyrtuar raporte të auditimit të brendshëm dhe raporte gjeneralë për 2020, gjithashtu ky komitet ka mbajtur 5 seanca, ku janë shqyrtuar pika të ndryshme sipas programit dhe planit të punës për vitin 2021. Në të gjitha takimet janë procesverbalet ku janë të regjistruara të gjitha diskutimet dhe konkluzat bashkë me të gjithë pjesëmarrësit në këto takime.

Kryesuesi – Faleminderit Sead, po kalojmë te pika e 9-të e rendit të ditës; **Të ndryshme**, kryetari Smajl Latifi e ka kërkuar fjalën.

Kryetari – Faleminderit kryesues, anëtarë të KPF-së. Vështirë është ta gjejmë një përfaqësues të zgjedhur, një njëri, një personalitet, një qytetar me përgjegjësi publike që do t'i them ndonjëherë që ne të kërkojmë sqarime nga uzurpatorët. Sigurisht një nga mbledhjet e kuvendit ose në këtë mbledhje në vijim bashkë me drejtorin e gjeodezisë mund t'i prezantojmë të gjitha të dhënat e nevojshme se si jemi me prona. Një gjë ju garantoj, si kryetar i komunës së Rahovecit asnjë lloj uzurpimi nuk e kam, as familja ime dhe në përputhje me ligjin uzurpatorët nuk do të kenë vend në Rahovec. Janë nisë disa veprime e disa rrënimë dhe nëpërmjet veprimeve intenzive inspektuese ta realizojmë misionin tonë për çmontimin e të gjitha veprimeve të kundërligjshme, sidomos zero tolerancë për uzurpatorë të cilët

vazhdojnë veprimtaritë të paligjshme dhe shfrytëzojnë kapacitetin ende të dobët të veprimeve kundër uzurpimeve. Jemi të vetëdijshëm që numri i inspektorëve është i pakët, njëri ka vdekë, tjetri është pensionuar. Jemi të vetëdijshëm që edhe konkursset për inspektorë janë duke dështuar në mungesë të interesimit. Mos harroni që komuna e Rahovecit shumicën dërrmuese e ka me njerëz të mirë e të ndershëm të cilët e dëshirojnë zhvillimin dhe sundimin e ligjit në këtë vend, prandaj do të kemi kapacitete të mjaftueshme për të bërë veprime intensive ndaj cilitdo uzurpatorë. Në qytet, në Krushë të Madhe, në Ratkoc dhe në çdo pjesë të lokalitetit, sidomos kur komuna e Rahovecit bashkë me kuvendit është dakort për këto veprime për përmbushjen e nevojave të zhvillimit ekonomik lokal.

Do të ketë befasi të hidhur sa i përket uzurpatorëve, do t'i prezantoj këtu para jush në projektor me të gjitha informatat e detajuara se kush zhvillon veprimtari në kundërshtim me ligjin, me asnjë kontratë prej askujt. E kam filluar një debat në Krushë të Madhe, një debat përmbajtësor të cilëve iu kam premtuar që me video projektor do të ftohen pretendentët. Vendimi i kuvendit për shpalljen në interes të përgjithshëm të një prone d.m.th. uzurpatori largohet dhe nuk lejohet privatizimi ose përvetësimi. Kur e kemi vendimin e kuvendit jemi shumë mirë dhe përfundon gjithçka, në rast se nuk e kemi atëherë kush mban përgjegjësi nëse prona nesër bëhet private. Përndryshe është detyrim ligjor që kuvendit i komunës bashkë me kryetarin e vet të mbrojë pronat publike komunale. Mosveprimi në këtë rast na nxjerr mundësinë e ngritjes së aktakuzës, sepse konsiderohet vepër penale kur kemi sinjale për rrezikimin e një prone dhe tentativë për përvetësim nga pronë publike në private e ne të mos veprojmë. Imagjinojeni që ndonjë përfaqësues i zgjedhur këtu të ketë kesi lloj uzurpimi, le ta ulë kokën dhe ta pyet veten se kënd e kanë votuar qytetarët, por asnjëherë të mos i shkoj mendja që komuna nuk mund të merr operatione të posaçme edhe me forcat e rendit të shkoj e t'i rrënojë objektet të cilat janë në pronë publike. Do të shkojmë deri në fund në sundim të plotë të ligjit sepse pas një kohe edhe prokuroria mund të thotë se pse nuk e kemi mbrojtur me vendim të kuvendit dhe nuk e keni shpallur në interes të përgjithshëm pronën e caktuar. Ne kemi edhe alternativën tjetër, prej sotit inspektorët do të kenë detyra shtesë me veprime dhe njoftime paraprake duke u mbështetur në baza ligjore që uzurpatorët mos të kenë vend.

Bejtullah Deliu – Faleminderit kryesues. Kryetar, ndoshta ndonjëherë reagimi im t'u është dukur mënyrë që unë po e bëjë për me të ndal në formë atakimi ose presioni, por kjo po më atakon direkt mua sepse unë kam qenë ai që kam kërkuar të hiqet prej rendit të ditës, por edhe në seancën e kaluar arsyeja e heqjes së këtyre pikave prej rendit të ditës ka qenë mungesa e konsultimit dhe debatit me qytetarë të Krushës së Madhe sepse ka pretendime të ndryshme. Ky ka qenë arsyetimi kryesor i asamblistit tonë Sejfullah Sejfullahu, që në seancën e kaluar të hiqet ajo pikë nga rendi i ditës, ku është respektuar edhe nga ekzekutivi. Nëse ka uzurpatorë patjetër që duhet të dënohen me ligj dhe të merren të gjitha masat e nevojshme, por kemi kërkuar që të mbahen konsultime në të cilat edhe ne si anëtarë të KPF-së të marrim pjesë dhe të argumentoj secili aty pse nuk duhet të shpallet në interes publik prona e caktuar, e më pas ne jemi ata që e vlerësojmë si kuvend. Nëse qytetarët atje nuk kanë argumente, atëherë pse mos ta shpallim zonë industriale apo çka do tjetër që është në interes për komunën e Rahovecit, thjesht duhet t'i heqim dyshimet që ne jemi të ndikuar prej ndonjë biznesi, nga etika ime familjare dhe personale ju garantoj që nuk ka biznes nga i cili mund të ndikohem, bile unë jam i dëmtuar bashkë me një shok timin biznesmen për një pikë që është votuar në favor të kuvendit të komunës. Faleminderit.

Krytari – Zakonisht është viti i 8-të që asnjëherë nuk kam qenë prezent në seanca të KPF-së, realisht nënkryetari ka qenë këtu rregullisht bashkë me drejtorë të cilët kanë pas pika të rendit të ditës. Kam

filluar një fazë të konsultimeve publike sipas kërkesave ligjore për çështje të buxhetit - planifikim dhe ecurinë e projekteve. Kemi qenë edhe në Krushë të Madhe, për çudi tema qendrore që ka dominuar takimin ka qenë çështja e pronave, në atë takim kanë qenë prezent edhe dy asamblistët e këtij kuvendi; Sejfullah Sejfullahu dhe Arbër Zenuni. Shpallja në interes të përgjithshëm në thelb është mbrojtje e pronës nga keqbërësit, përveç që mund të bëjmë shumë gjera tjera sipas planit të kuvendit dhe komunës. Kadastra jonë ka shumë shembuj se si në komunën e Rahovecit pronat publike janë kthyer në private, një nga këto raste është tregu i ri në Ratkoc, ose forma e tij që është trekëndësh, sepse pjesa tjetër është bërë private, kemi tentuar në atë kohë ta mbrojmë, por vendimet gjyqësore e bëjnë punën e vet, sikur ta kishim pasur në interes të përgjithshëm atë pronë, kurrë nuk kishte ndodhur ajo gjë. E mora shembull Ratkocin, se si një pronë publike në mungesë të vendimit për shpalljen e interesit të veçantë të mbrojtur nga kuvendi i komunës ka mundur të bëhet pronë private. Detyra ime është të kem vizion dhe të parashikojmë se çka mund të ndodh nesër pas 5 viteve apo 6, për këtë arsye duhet ta kemi vendimin, përndryshe nesër ose pasnesër në një ditë të mirë me diell vjen momenti dhe prona nuk është më publike dhe kush është përgjegjës në këtë rast? Prandaj çdo pronë duhet ta mbrojmë me vendim të kuvendit, sepse kryetari pa vendim të kuvendit nuk ka mundësi t'i mbrojë ato prona, prandaj neve LVL na ka përcaktuar funksionet, përgjegjësitë dhe detyrimet, prandaj disa gjëra ne duhet t'i kalojmë në kuvend. Ju mos e vendosni në kuvend ose mos e shpallni hiç, por po ju tregoj që operacioni i largimit të "pronarëve" që në mënyrë të paligjshme kanë uzurpime arbitrare ka filluar sot dhe shpresoj që në këtë kuvend nuk do ta ulë kokën askush, sepse në fund unë e mbajë kokën lartë.

Kudo që ka prona, në qytet, në Ratkoc, në Xërxe, në Opterushë, fillimisht do t'i mbrojmë me vendim të kuvendit dhe pastaj të mendojmë se çfarë projektesh investive të realizojmë në ato zona. I kemi dëgjuar qytetarët që thonë; pse nuk vijnë investitorët këtu? Kushti i parë është nëse kemi pronë publike dhe infrastrukturë të zonës, prandaj kjo vonesë nuk ka justifikim. Diçka që është e çuditshme, që për 23 vite në komunën tonë kemi lejuar nga mosveprimi ynë, në mes të qytetit të stacioni i autobusëve të operojë uzurpatori ilegalisht, e sot është më pastër se sa që ishte dje sepse e kemi vendimin. E një nga prioritetet për këtë mandat e kam betejën ligjore për largimin e uzurpatorëve, me aksione të vazhdueshme do të largohen pronarët e paligjshëm dhe uzurpatorët arbitrar çoftë edhe prindi im. Vendbanimi i dytë pas qytetit të Rahovecit është Krusha e Madhe, në këtë rast ne e kemi një ofertë për Krushën e Madhe, dy parcela t'i shpallim me interes të përgjithshëm, ta bëjmë të ligjshme. Situatat janë shumë të qarta për ata që dëshirojnë t'i kuptojnë.

Bejtullah Deliu – Mirë kryetar, arsyeja e vetme që këto pika të rendit të ditës janë tërhequr, ka qenë vetëm mungesa e debatit me qytetarë atje dhe arsyeja e tërheqjes nuk është zbatuar.

Nëse qytetarët e Krushës nuk kanë argumente jemi shumë në rregull, në çoftëse kanë prapë do të shqyrtohen këtu në kuvend. Besoj që jemi në rregull për këtë.

Kryesuesi - Faleminderit Bejtullah, faleminderit të nderuar anëtar të KPF-së, drejtorë, kryetar, nënkryetar deri në seancën e rregullt, mire mbetshi.

Mbledhja përfundoj në 10:45


Procesmbajtësi,
Agim Hoti


KRYESUESI
Dejrim Kafexhiu